



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:233524

Datë: 10.10.2023

Numri i dokumentit: 04770653

**PAKR.nr.451/23**

**NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Hashim Çollaku - kryetar, Xhevdet Abazi dhe Zyhdi Haziri, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sadik Kryeziu, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.B nga fsh. ..., ..., për shkak të veprave penale vrasje e rëndë nga neni 173 par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së, shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par. 1 të KPRK-së dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesat e përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar, av. Florim H. Shefqeti dhe mbrojtësit të akuzuarit B.B, av. Azem Ejupi, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore - DKR në Prishtinë, PKR.nr.365/22 i datës 16.06.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 par. 1 të KPPRK-së, me datë 06.10.2023, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Me aprovimin e pjesërishtëm të ankesës së përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar, NDRYSHOHET, aktgjykimi i Gjykatës Themelore - DKR në Prishtinë, PKR.nr.365/22 i datës 16.06.2023, vetëm përkitazi me vendimin për dënim dhe atë përkitazi me veprën penale vrasje e rëndë nga neni 173 par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së, ashtu që, kjo gjykatë, të akuzuarin B.B, për veprën penale vrasje e rëndë nga neni 173 par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së, i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 22 (njëzet e dy) vjet, dhe pasi i merr si të vërtetuara dënimet e shqiptuara nga gjykata e shkallës së parë, dhe atë, për veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par. 1 të KPRK-së, dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vjet dhe për veprën penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vjet, bazuar në dispozitat e nenit 76 të KPRK-së, e gjykon me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 23 (njëzet e tri ) vjet e 6 (gjashtë) muaj, në të cilën dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 18.10.2021, e tutje.

Ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar, për vendimin për dënim, përkitazi me veprat penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par. 1 të KPRK-së dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, dhe ankesa e mbrojtësit të akuzuarit B.B, hudhen si të palejuara, ndërsa, aktgjykimi i ankimuar për pjesën tjetër vërtetohet.

## A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore - DKR në Prishtinë, PKR.nr.365/22 të datës 16.06.2023, i akuzuari B.B, është shpallur fajtor për shkak të veprave penale vrasje e rëndë nga neni 173 par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së, shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par. 1 të KPRK-së dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, dhe për këto vepra penale, pasi më parë i ka shqiptuar për veprën e parë penale dënim me burgim në kohëzgjatje prej 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjet, ndërsa, për veprën e dytë penale me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vjet, si dhe për veprën e tretë penale me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vjet, me aplikimin e dispozitave për shqiptimin e dënimit për veprat penale në bashkim, bazuar në dispozitat e nenit 76 të KPRK-së, i akuzuari B.B, është gjykuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 17 (shtatëmbëdhjetë) vjet e 6 (gjashtë) muaj, në të cilën dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 18.10.2021, e deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit.

Të akuzuarin, po ashtu, e ka obliguar që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa, në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 100 €, kurse në Fondin për kompensimin e Viktimave të Krimit shumën prej 50 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesa kanë paraqitur;

Përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar, av. Florim H. Shefqeti, për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar dhe të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i ashpër me burgim, se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.B, av. Azem Ejupi, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit për dënim, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit t'i shqiptojë dënim më të butë se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

Gjykata e Apelit, seancën e kolegjit e mbajti konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK, për të cilën njoftoi Prokurorin e Apelit, të dëmtuarën N.B, përfaqësuesin e aturoizuar të palës së dëmtuar, av. Florim Shefqeti, të akuzuarin B.B dhe mbrojtësin e tij, av. Azem Ejupi. Në seancën e kolegjit ishin të pranishëm përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar, av. Florim Shefqeti, e dëmtuara N.B, mbrojtësi i të akuzuarit av. Azem Ejupi dhe i akuzuari B.B, ndërsa, edhe pse të ftuar në mënyrë të rregullt nuk prezantoi Prokurori i Apelit. Në seancën e kolegjit përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar, pasi më parë bëri elaborimin e pretendimeve si në ankesë, ngeli në tërësi pranë propozimeve si në ankesë, të cilën e përkrahu edhe e dëmtuara N.B, ndërsa, mbrojtësi i të akuzuarit B.B, av. Azem Ejupi, deklaroi se pasi më parë u konsultua edhe me të akuzuarin, e njofton gjykatën se e tërheq ankesën e paraqitur kundër aktgjykimit të gjykatës së

shkallës së parë, ndërsa, përkitazi me ankesën e përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar, gjykatës i propozon që e njëjta të refuzohet si e pabazuar, ndërsa, aktgjykimi i shkallës së parë, të vërtetohet.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtresën PPA/I.nr.414/2023 i datës 02.08.2023, ka propozuar që ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar, të aprovohet, ashtu që, aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit t'i shqiptohet dënim me burgim më të ashpër, ndërsa, ankesa e mbrojtësit të akuzuarit të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit, pasi që i shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes së bashku më aktgjykimin e ankimuar, të cilat i vlerësoi konform dispozitës së nenit 394 të KPPRK-së, dhe pas vlerësimit të pretendimeve të theksuara në ankesa, gjeti se:

Ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar është pjesërisht e bazuar, ndërsa, ajo e mbrojtësit të akuzuarit hudhet si e palejuar.

Pretendimet ankimore përkitazi me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe gjetjet e gjykatës.

Me ankesën e përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar, av. Florim Shefqet, aktgjykimi i shkallës së parë, nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë, Gjykata e Apelit, të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtojë edhe në këtë aspekt konform dispozitave të nenit 394 të KPPRK-së, dhe konstatojë se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimin.

Po ashtu, edhe gjendja faktike në këtë çështje penale-juridike nuk ka qenë objekt i vlerësimit të kësaj gjykate nga se me ankesa nuk ka mund të kontestohet, pasi që i akuzuari, në shqyrtimin gjyqësor e kanë pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës dhe trupit gjykues është pajtuar me një pohim të tillë konform nenit 322 par. 4 të KPPRK-së.

Pretendimet ankimore përkitazi me vendimin për dënim dhe gjetjet e gjykatës.

Duke e shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, përkitazi me veprën penale vrasje e rëndë nga neni 173 par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së, Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet ankimore të përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar, përkitazi me veprën penale vrasje e rëndë nga neni 173 par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së, se dënimi i shqiptuar është i butë dhe jo proporcional me rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, janë të bazuara.

Në ankesën e përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar, përkitazi me këtë bazë ankimore për veprën penale vrasje e rëndë nga neni 173 par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së, theksohet se dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë, nuk është adekuat me veprën penale por as me pasojën e shkaktuar, ngase, gjykata e shkallës së parë, edhe pse ka vendosur drejtë kur të akuzuarin e ka shpallur fajtor, gjatë matjes së dënimit nuk ka marr për bazë shkallën e dëmit të shkaktuar, shkallën e përgjegjësisë penale dhe motivet për kryerjen e veprës penale, pastaj, e njëjta, ka bërë mbivlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe atë, sidomos, kur, nuk ka bërë

shqiptimin e dënimit analog me rrethanat në fjalë, e duke shtuar se po ashtu, e njëjta-pra, gjykata e shkallës së parë, nuk ka marr parasysh të gjitha rrethanat rënduese që janë të parapara sipas KPRK-së, ku, përveç, që nuk ka bërë vlerësimin real të rrethanave rënduese që i ka marr parasysh, si shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, mënyrën e kryerjes së veprës penale, shkallën e lartë të dashjes së të akuzuarit për kryerjen e veprës penale të vrasjes, e në kontest të këtyre rrethanave është mbiçmuar rrethana lehtësuese - pranimi i fajësisë dhe atë duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e nenit 70 par. 2 të KPRK-së. Më tutje, në ankesën e përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar vazhdohet me sqarimin e secilës rrethanë rënduese, që gjykata e shkallës së parë, ka pasur parasysh, por, nuk e ka vlerësuar në mënyrë reale, duke dhënë kështu, arsyerat në ankesë se përse, është dashur të vlerësohen në mënyrë më reale rrethanat rënduese në fjalë, ku, më pastaj, vazhdohet me konstatimin se ka edhe rrethana tjera rënduese, që nuk janë marr parasysh, sidomos, dëmin e shkaktuar familjes së tani të ndjerit, ku, përveç, humbjeve që janë shkaktuar nga vdekja e tani të ndjerit, familjes së tij i është pamundësuar edhe shfrytëzimi i pronës-shtëpisë dhe sendeve të tyre, duke qenë se janë në fqinjësi me familjen e të akuzuarit, prandaj, këto rrethana lidhur me pasojën e humbjes së kryefamiljarit paraqesin si të domosdoshme që Gjykata e Apelit, ta bëjë vlerësimin edhe të kësaj rrethane rënduese, pastaj, potencohet fakti se i akuzuari edhe më parë ka kryer vepër tjetër penale ndaj tani të ndjerit dhe familjes së tij dhe atë vetëm një ditë para kryerjes së veprës penale të vrasjes dhe se vepra penale në fjalë, është kryer edhe në prezencën e bashkëshortes dhe fëmijëve të tani të ndjerit, pastaj, nuk është marr parasysh rrethana rënduese se i akuzuari ka privuar nga jeta djalin e axhës së tije, pra, të afërmit të familjes, pastaj, moshën e tani të ndjerit si dhe faktin se tani ka mbetur pa mjete për mbijetesë bashkëshortja e tani të ndjerit dhe 3 fëmijët e mitur, për çka, edhe ka shqiptuar dënim shumë të butë, prandaj, edhe propozon ndryshimin e aktgjykimit të ankimuar dhe të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i rëndë me burgim në proporcion me veprën e kryer penale.

Gjykata e Apelit, duke i pasur parasysh rrethanat e vërtetuara e në të cilat është bazuar gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqiptimit të dënimit të akuzuarit për veprën e kryer penale, pra, të vrasjes së rëndë nga neni 173 par. 1 nën par. 4 të KPRK-së, e në të cilat thirret në arsyetimin e aktgjykimit, e duke i vlerësuar të njëjtat në raport me pretendimet ankimore të përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar, i gjen si të bazuara pretendimet e përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar, se dënimi i shqiptuar është i butë dhe jo adekuat me rrezikshmërinë por, edhe pasojën e veprës penale të vrasjes së rëndë nga neni 173 par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, me rastin e shqiptimit të dënimit, gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform dispozitave të neni 69 dhe 70 të KPRK-së, si rrethana lehtësuese për të akuzuarin B.B, ka marrë, se i akuzuari ka pranuar fajësinë, ndërsa, si rrethana rënduese, shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, atë, të përgjegjësisë penale të akuzuarit, e sidomos, pasojën e veprës penale, pastaj, faktin se ka privuar nga jeta djalin e axhës-pra, të afërmin e familjes dhe në bazë të rrethanave të konstatuara dhe të vlerësuara gjykata e shkallës së parë, të akuzuarit i ka shqiptuar dënim si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë, në këtë çështje penalo - juridike, edhe pse drejtë i ka konstatuar disa nga rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat i ka gjetur tek i akuzuari, të njëjtat nuk i ka vlerësuar realisht dhe atë, sidomos, rrethanat lehtësuese, që ka të bëjë me pranimin e fajësisë, rrethanë kjo e cila është mbiçmuar nga gjykata e shkallës së parë, ngase, edhe kur, i akuzuari e pranon fajësinë gjatë caktimit të lartësisë së dënimit, duhet të bëhet vlerësimi i rrethanës në fjalë, në raport edhe me rrethanat rënduese, gjë, që, në rastin konkret duke pasur parasysh rrethanat rënduese në këtë çështje penalo-juridike, atëherë, rezulton se

pranimi i fajësisë është mbivlerësuar, pastaj, në rastin konkret nuk janë vlerësuar realisht as rrethanat rënduese, e sidomos, fakti se i akuzuari ka privuar nga jeta djalin e axhës së tij, pra, me të dëmtuarin kanë qenë në raporte të afërta familjare, pastaj, nuk ka marr parasysh edhe rrethanat tjera rënduese, e që, me të drejtë potencohen në ankesën e përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar, moshën e tani të ndjerit, se i akuzuari B.B, edhe më parë ishte sjellë në mënyrë kërcënuese ndaj tani të ndjerit dhe familjes së tij, ku, vetëm një ditë më parë kishte kryer veprën tjetër penale ndaj të ndjerit dhe familjes së tij, pastaj, se si pasojë e veprës penale në fjalë-pra, të vrasjes, ka mbetur e ve bashkëshortja e tani të ndjerit N.B, dhe atë edhe me tre fëmijë të mitur, e kështu, edhe pa përkujdesje familjare, ngase, tani i ndjeri ishte mbajtës i vetëm i familjes së bashku me fëmijët e mitur, pastaj, se si rezultat i veprës penale të vrasjes, tani bashkëshortja e tani të ndjerit së bashku me tre fëmijët e mitur të sajë, nuk ka mundësi që ta shfrytëzojë pronën e sajë, për shkak të raporteve jo të mira me familjen e të akuzuarit, me të cilën jetojnë në afërsi, atëherë, rezultojnë se janë të gjitha këto rrethana rënduese, që po ashtu, gjykata e shkallës së parë, nuk i ka vlerësuar realisht, e që me të drejtë potencohen edhe nga përfaqësuesi i autorizuar e palës së dëmtuar, e që në krahasim me rrethanat konkrete lehtësuese, rezultojnë se dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë, është i butë, për çka, kjo gjykatë e ndryshoi aktgjykimin e ankimuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pra, duke i shqiptuar të akuzuarit për veprën penale të vrasjes së rëndë nga neni 173 par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së, dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 22 (njëzet e dy) vjet.

Prandaj, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, në praninë e rrethanave lehtësuese dhe rënduese të konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, e të vlerësuar realisht tani nga Gjykata e Apelit, por duke marrë parasysh edhe rrethanat rënduese të konstatuara tani nga kjo gjykatë, rezultojnë se dënimi i shqiptuar tani të akuzuarit për veprën penale të vrasjes së rëndë nga neni 173 par. 1 nën par. 4 të KPRK-së, nga Gjykata e Apelit, është i drejtë dhe i ligjshëm dhe në harmoni me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, po ashtu, i njëjti është në funksion të preventivës gjenerale, por edhe asaj individuale dhe se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në dispozitat e nenit 38 të KPRK-së.

Gjykata e Apelit, pati parasysh ankesën e palës së dëmtuar, përkritazi me vendimin për dënim edhe për veprat penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par. 1 të KPRK-së dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, por, bazuar në dispozitat e nenit 381 par. 3 të KPRK-së, të njëjtën e hudhi si të palejuar, ngase, me dispozitat në fjalë parashihet se i dëmtuari mund të paraqesë ankesë ndaj aktgjykimin dhe atë vetëm për vendimin e gjykatës, lidhur me sanksionet penale dhe atë për veprat penale që përfshihen në kapitujt; kundër jetës dhe trupit, për trafikim me qenie njerëzore, dhunë në familje, kundër integritetit seksual dhe kundër sigurisë së trafikut publik si dhe tek vendimet mbi shpenzimet e procedurës penale, e që në rastin konkret bëhet fjalë për veprat penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par. 1 të KPRK-së dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, e që veprat penale në fjalë nuk përfshihen, në kapitujt e cekur më lartë, prandaj, Gjykata e Apelit, e hudhi ankesën e palës së dëmtuar, përkritazi me vendimin për dënim, për veprat penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par. 1 të KPRK-së dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, si të palejuar.

Po ashtu, ankesën e mbrojtësit të akuzuarit B.B, av. Azem Ejupi, të paraqitur kundër aktgjykimin të gjykatës së shkallës së parë, kjo, gjykatë bazuar në dispozitat e nenit 400 të KPRK-së, e hudhi si të palejuar, pasi që, në seancën publike të kolegjit të kësaj gjykate, mbrojtësi i të

akuzuarit av. Azem Ejupi, me pëlqimin edhe të akuzuarit B.B, e tërhoqi ankesën e paraqitur kundër aktgjykimit të ankimuar, prandaj, edhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit.

Nga sa u parashtrua më lartë, e konform dispozitës së nenit 381, 400 dhe 403 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PAKR.nr.451/2023 data 06.10.2023**

Procesmbajtës,  
Sadik Kryeziu

Anëtarët e kolegjit,  
1. \_\_\_\_\_  
Xhevdet Abazi  
2. \_\_\_\_\_  
Zyhdi Haziri

Kryetar i kolegjit,  
Hashim Çollaku